

SASHENKA KAMBERI

**VEÇORI TË GJUHËS DHE STILIT NË ROMANIN *DARKA E GABUAR*  
TË ISMAIL KADARESE**

Ismail Kadare është një nga romancierët më të shquar shqiptarë, vepra e të cilit jo vetëm është botuar në shumë gjuhë të botës, por ka marrë shumë çmime e vlerësime nga kritika botërore. Bashkë me krijimtarinë është bërë i njohur edhe qyteti i lindjes, Gjirokastra, e cila me vizatimin magjik që i ka bërë shkrimtari ka magjepsur lexues të kudondodhur. “Kronikë në gur” është i pari roman që krahas arkitekturës, i bënë një analizë të hollë jetës dhe psikologjisë së qytetit me mendësi komplekse e të çuditshme. Më tej ai ka vazhduar me një varg tregimesh e romanesh të frymëzuara nga histori, rrëfime, ngjarje, përjetime gjatë jetës në këtë qytet. Në të gjitha rastet qyteti paraqitet *i veçantë, madhështor, krenar*, por dhe *enigmatik, i padeshifrueshëm*, e madje *i marrë e i çmendur*.

Kjo ndjesi shfaqet dhe në romanin “Darka e gabuar”, ku shkrimtari rikthehet në një histori që kishte tronditur Qytetin e tij në pragpushtimin gjerman. Mjegullnaja që vesh ngjarjen e bën më interesant rrëfimin e Kadarese. Përtej zgjedhjes dhe trajtimit origjinal të historisë sa të njohur aq dhe të paqartë, shkrimtari si në gjithë krijimtarinë e tij të mahnit me gjuhën e pasur dhe stilin e tij origjinal e të paimitueshëm. Vlerat e letërsisë së tij pasurohen me thesarin gjuhësor që ato ofrojnë, aq sa në rastin e tij është e vështirë të veçosh shkrimtarin nga gjuhëtari.

Pasuria leksikore e kuptimore kadareane, marrëdhëniet dhe lidhjet e pazakonta të fjalëve si dhe krijimi i fjalëve e kuptime të reja, të magjepsin me dimensionet e tyre. Duke qenë se Kadare *shquhet si shkrimtari që e zgjedh mirë fjalën, në përshtatje me idetë e veprave që krijon, po edhe e peshon, e mat mirë atë*<sup>1</sup>, forca shprehëse e tyre është mbresëlënëse. Edhe në këto mikrosisteme është e pamundur të bësh një analizë shteruese të të gjithë tipareve stilformuese, të veprës e të autorit e të ndërtosh tipologjinë e plotë leksiko-semantike të veprës.

“Darka e gabuar” ashtu si gjithë krijimtaria e Kadarese, bën përshtypje me fjalëkrijimet origjinale, **neologjizmat**. Denduria dhe mjeshtëria e formimit të fjalëve të reja është një tipar stilformues për autorin, i cili me anë të gjetjeve fjalëformuese, iu jep tjetër vlerë fjalëve të zakonshme. Fjalëkrijimet e përdorura prej tij, përveç pasurisë leksikore, dallojnë edhe për vlerat stilistikore. Për krijimin e fjalëve të reja shkrimtari ka përdorur në mënyrë origjinale modelet fjalëformuese që ofron shqipja.

Në roman të heqin vëmendjen kompozitat, qoftë për mënyrën e njëfjalësimit të fjalëve, qoftë për forcën shprehëse. *Kadareja i krijon këto* (fjalët e reja -

---

<sup>1</sup> Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009 f. 158.

shënimi ynë) nën shtysën e mendimit abstrakt letrar, nën shtysën e përfytyrimeve të tij të reja, që kërkojnë sigurisht edhe një veshje të re.<sup>2</sup> Të tilla janë disa fjalë me përbërje, si: *qiellzanat, brinjathyes, këmishnatat, fajshpërndarës, grarrëmbyes, virtytomëdhenjtë, vendvështrim, orëligj, fortafolësi* etj., ku dallohen qartë kufijt e fjalëve përbërëse. P.sh.: ...vetë zonjat, me **këmishnatat e mëndafsha**... (f. 22); ...të zbuste mërinë ndaj **brinjathyesit** (f. 20); ...për të mos acaruar **virtytomëdhenjtë** shqiptar... (f. 77) etj.

Disa fjalë me prejardhje prapashtesore, si: *hënëzim, dritësim, pengëtim, zonjëzim, shemërimi, gjermanizimi, zymtor, i pranguari* etj. janë krijuar sipas modelit të formimit të emrave abstraktë në gjuhën shqipe. P.sh.: ...një farë ikjeje në larginë a një **hënëzim**, shenja të para të **zonjëzimit** (f. 111); ...por, këtë herë **zymtor e dramatik** (f. 61); Ishte një joshje nga **gjermanizimi** (f. 161) etj.

Gjatë leximit të bie në sy se shkrimtari ka përdorur më rrallë parashtesat për formimin e fjalëve të reja. Shembuj si: *nënharkoren* (pjesë e shtëpisë gjirokastrore) i *stërerrëti* (kapërcen masën, *Tek ai më i errët e i stërerrët*) i gjejmë edhe në romane të shkruar më parë.

Po kështu edhe fjalë si: *pikëllimtar, idhulltar, vramendje, fajkërkues, bjerraditës, dritësim* etj., janë fjalëkrijime të autorit të përdorura në vepra të mëparshme.

E veçantë në këto fjalëkrijime është se Kadare *sjell prurje që të gjithëve na dukej se i dinim, por ato vetëm kur i lexojmë tek ai na duket se zbulohen për herë të parë*.<sup>3</sup> Sipas mendimit të profesor Gj. Shkurtaj, neologjizmat kadareane nuk janë artificiale, ato i kanë qëndruar kohës dhe e kanë përligjur veten.<sup>4</sup> Në këtë mënyrë bashkë me vlerat leksikore e stilistikore, tërheqin vëmendjen dhe edukojnë shijen e lexuesve.

Përveç fjalëve të reja, gjuha në romanin “Darka e gabuar”, ashtu si në gjithë krijimtarinë e autorit, pasurohet me **sinoniminë** e përzgjedhur me kujdes. Njohuritë e thella gjuhësore, aftësia për të përdorur variantin e duhur sinonimik dhe bashkëvendosja e fjalëve në çifte dhe vargje sinonimike e bëjnë shumë të pasur ligjërimin prozaik të autorit, i cili shmang çdo lloj përsëritjeje të pamotiveshme, duke përdorur fjalë të ndryshme për të njëjtin tipar a dukuri. P.sh.: në kreun *Zi zonjash*, për fenomenin e “rënies së zonjave” njëra pas tjetrës autori ka përdorur disa fjalë për të përshkruar gradualisht goditjen e tyre. *E goditura vazhdoi të mbetej si e ngrirë në vend...gjunjët iu drodhën dhe ra në kalldrëm. Kështu, brenda një dite ranë zonjat Nermin Fico e zonja Sabeko e Zekatëve, ...por të tjerat u rrëzuan pa thënë asgjë. Zonjat njëra pas tjetrës po këputshin. Nuk ishte e vështirë të kuptohej zonjat ish in thyer* (113).

<sup>2</sup> N. Sotiri, *Vëzhgime rreth ndihmesës së I. Kadaresë për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme letrare*, “Gjuha jonë”, 1-4, 1997.

<sup>3</sup> Gj. Shkurtaj, *Pesha a fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 164.

<sup>4</sup> K. Bihiku, *Roli i shkrimtarëve për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës letrare*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1985, f. 37.

## Veçori të gjuhës dhe stilit në romanin *Darka e gabuar* të I. Kadaresë

Kujdesi i dukshëm për përpikmëri, qartësi e sidomos për shprehësi e shtynë shkrimtarin në bashkëvendosjen e fjalëve të afërta kuptimisht a kontekstualisht, si: *me bujë e tralala* (f. 8); bëhej *bujshëm e brutalisht* (f. 19); *zhurmat e gërvimat* (f. 29); *kryeneç e idhnak* (f. 16); gjithçka *hirnosej e vjetërohej* (f. 96) etj., të cilat më tepër se sinonime leksikore janë sinonime stilistikore kontekstuale. Në këto raste vetëm njëra nga fjalët është e domosdoshme për thënien, gjymtyra tjetër i shtohet gjymtyrës së dhënë duke formuar një tërësi kuptimore. Këto sinonime karakterizohen nga diferenca në nuancat kuptimore dhe ngjyrimi stilistikor. Bashkëvendosja e tyre çon në zgjerimin kuptimor të thënies. Stilema e përfutur në këto raste u kundërvihet njësisive të marra veç për nga përmbajtja, që është më e gjerë, për nga ngjyrimet kuptimore dhe emocionuese që janë më të shumta, për nga shprehësia më e lartë.<sup>5</sup>

Siç ndodh shpesh, sinonimet e përdorura kanë funksion saktësimi. Me anë të zgjerimit semantik shkrimtari jo vetëm qartëson e saktëson mendimin, por e vesh atë stilistikisht. Mjeshtërinë e tij për të ndërtuar analogji e shpreh me anë të përzgjedhjeve leksikore P.sh.: Stalini ishte *më i madh e më hijerëndë* se sulltani dhe i tillë, *i madh e i rëndë plumb* do të ishte pezmi i tij (f. 120); Me përjashtim të *një çasti të shkurtër, një grimë kohe* të mbuluar me mjegull (f. 204) etj.

Në roman një tip më vete përbëjnë çiftet apo vargjet e sinonimeve që zgjerohen me një krahasim, i cili plotëson kuptimin e sinonimeve paraprijëse. P.sh.: Ky ishte një *ankth i veçantë, nazik, si një maçok i ngopur mendjemadh* dhe disi *i pafytyrë* (f. 13); *shpërfillës e hijerëndë* si rrallëkush (f. 137); *E plotë, e patretur si mumja* (f. 135); dhe pastaj *çngurosj* njëra pas tjetrit, *ringjallja si në pashkë* (f. 72); *E ndritshme, e lehtë, si e porsa dalë nga shkuma e govatës* (f. 96).

Vargu sinonimik është një tjetër vlerë e ligjërit të Ismail Kadaresë. Mbizotëron vargu *i sinonimeve me grupime treshe, të cilat krijojnë idenë e tri të shtënave të njëpasnjëshme. Ato nuk të lënë të ikësh për asnjë çast nga ideja që kërkon të theksojë autori.*<sup>6</sup> P.sh.: Ai do të ndëshkohej sipas ligjeve të luftës, që s'merrej parasysh nëse ishte *sqimtar, i rrjedhur nga mosha, madje i çmendur* (f. 24); *Urdhra, paralajmërime, kumte të fshehta e përshkonin humnershëm* (f. 129); *ishin mëkatet e jashtme, të bujshme e të dukshme* (f. 64); *Të hidheshe në erë, të lëkundeshe, të kërceje pupthi, të gjitha këto u shkonin veç grave* (f. 23) *në majën e pushtetit: komplete, klane, tmerre* (f. 117) etj. Në këto vargje të bien në sy përftesa me sinonime që kanë natyrën e një shkallëzimi të tiparit ose kërkon ta vërë në dukje atë tipar<sup>7</sup>, çka do të thotë se në vargëzimin e shkallëzuar përfshihen edhe sinonime kontekstuale<sup>8</sup>, të cilat kanë efekt më të lartë, duke qenë të papritura për lexuesin. Kështu, në përdorimin e tyre nuk kemi të bëjmë me vargimin apo

<sup>5</sup> E. Sadiku, *Zgjerimi semantik në letërsinë artistike*, "Gjuha jonë", 3, 1988, f. 15.

<sup>6</sup> Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, f. 160.

<sup>7</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika* (ribotim), Tiranë, 2005, f. 138

<sup>8</sup> Po aty.

*rreshitim* e tyre, por me një materie mjaft të ndjeshme<sup>9</sup>, të kapshme brenda tekstit.

Në këto çifte e vargje sinonimike ajo që tërheq më tepër vëmendjen nuk është afria e njësisve më tepër se diferencimi mes tyre, i cili vjen nga ngjyrimi emocional apo variacioni stilistikor që sjell një fjalë përkundrejt tjetrës. Pra, diferencimi i shfaqur nga ngarkesa që mbartin njësitë, shoqërohet me hijezime kuptimore, të cilat ndikojnë në saktësimin e nocionit që shprehin.

Vihet re se fjalët që formojnë çifte dhe vargje sinonimike janë kontekstuale. P.sh.: *Ishte thjesht diçka e beftë, e pavend, shi në kohën që s'duhej* (f. 50); *një shpjegim lehtësues e fajshpërndarës* (f. 26); *zhurmat e gërvimat* (f. 29); *më habitshëm e më moskuptueshëm* (f. 34); *e folura në të kishte qenë diçka e vetvetishme, e pamenduuar* (f. 54); *Zëri iu bë prapë i pikëlluar, i shprishur* (f. 55); *Fasha të përgjakura, britma, urrejte, tmerr...* Kështu shpjegohej katrahura e pafund, *sharjet, ahtet, britmat* (f. 81) etj. Konteksti afron fjalë që nuk shënojnë të njëjtin nocion, por i ndihmon të plotësojnë kuptimisht njëra-tjetrën.

Dukuria e **antonimisë** na shfaqet po aq e pasur dhe me shumësi lidhjesh e shprehësi të lartë në roman. *Fjalët antonime janë fenomen gjuhësor, por njëkohësisht ato janë dhe fenomen stilistik - stilema*<sup>10</sup>, pasi shndërrohen në antiteza. Për vetë subjektin, personazhet dhe ngjarjen që trajton, antiteza është një përftesë mjaft e përdorur në romanin “Darka e gabuar”. Disa prej tyre janë: *të pikëlluara a të lumtura* (f. 18); në vend që *t’i gëzonin, i kishin acaruar* (f. 20); *të hareshme e të lemerishme* (f. 35); *gjithfarë premtimesh a kërcënimesh* (f. 96); *ujë që mungon, ujë që tepron*. Shkurt, *ujë i duhur, ujë i gabuar* (f. 97); sa ç’ ishte ajo *e bardhë, aq i zi* ai ngjante në zemërimin e vet (f. 130); unë që *ju gëzova, unë po ju hidhëroj* etj.

Ngjashmëria dhe dallimi mes dy doktorëve, Gurameto i madh dhe Gurameto i vogël, për gjatë gjithë romanit jepet me sinonime e antonime të shumta. Megjithatë, *shemërimi* mes tyre transmetohet me një sërë kontrastesh. Që në fillim të romani ata prezantohen: *Në ta gjitha rrethanat kishte qenë doktor Gurametoja i madh që kishte dalë si të thuash, i fituar, ndonëse kjo fjalë mund të dukej tepër e fortë, ashtu siç ngjante e tepruar fjala “humbje” për tjetrin* (f. 8). Edhe pse nuk bëhet fjalë për antonime të mirëfillta leksikore, poeti realizon për qëllime artistike kundërvënie stilistikore interesante. Vendosja opozicionale e koncepteve a ideve është një tipar i veçantë në roman. Raste të tjera janë: *Thashethemet për to* (partizanet vajza) *kishin qenë kundërthënëse: ose “virgjëresha të kuqe”, që të vrisnin për më të voglin ngacmim, ose të harbuara për dashuri* (f. 89); *nuk e kishin as vazhdimësinë e mërzitshme e as ndërprerjen e çthurur* (f. 48); *Pas ëndrrës për të qenë në majë, qyteti po binte në gropë të botës...* (f. 120); *enigma e tyre, ashtu si e vërteta e tyre, ne s’na duhet* (f. 171) etj. Pra, më tepër se sa për fjalë antonime bëhet fjalë për kundërvënie stilistikore.

<sup>9</sup> Sh. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985, f. 73.

<sup>10</sup> I. Goçi, *Antonimet stilistike në gjuhën shqipe*, “Studimet filologjike”, nr. 1, 1987, f. 115.

## Veçori të gjuhës dhe stilit në romanin *Darka e gabuar* të I. Kadaresë

Po kaq interesante duket dhe loja me **poliseminë**, një tjetër mjeshtëri e gjeniut krijues. Përveç zgjerimit të paradigmatave kuptimore autori luan me kuptimet e fjalëve, duke krijuar trope gjuhësore, por edhe duke i përdorur kuptimet e fjalëve jashtë konteksteve të zakonshme. Kështu shumëkuptimësia kthehet në burim shprehësie. Përftesa më tipike është marrja me kuptim të drejtpërdrejtë e fjalëve që janë pjesë e togut idiomatik, i cili ka një kuptim që nuk është shumë e kuptimeve të fjalëve përbërëse. P.sh.: *Ishin harruar lëkundjet e autoritetit të secilit, dhe kjo ishte njëlloj si të humbte busulla, barometri që tregonte trysninë e ajrit, uljen dhe ngritjen e temperaturës, për të mos përmendur buletin e bursës, bashkë me zhvlerësimin e parasë* (f. 31). Vihet re se si Kadareja luan me kuptimet e fjalëve, duke bërë një shpjegim të drejtpërdrejtë të njërës nga fjalëve të togut frazeologjik e duke e dhënë së pari kuptimin e figurshëm e më pas ato të drejtpërdrejta. Ndërsa në rastin: *ndihmuan që rikthimi i mendjes së ikur të bëhej më shpejt dhe qyteti të fitonte atë për të cilën më së shumti ishte krenar, gjykimin e ftohtë* (f. 34) shkrimtari ndërton *rikthimi i mendjes* si opozicion i njësisë frazeologjike *i iku mendja*. Është interesante loja që Kadare bën me kuptimet e fjalëve duke shfrytëzuar shprehësinë kontekstuale.

Tipar i rëndësishëm stilformues në ligjërimin artistik të Ismail Kadaresë është figuracioni origjinal e përshtypjebërës. Edhe në romanin që ne kemi marrë në analizë bie në sy mjeshtëria e autorit për të shoqëruar mendimin me gjuhë të pasur e figura të larmishme, nga më të thjeshtat e deri te ato më abstraktet.

Figurë e rëndësishme në roman është *sinekdoka* e përfutur nga përdorimi i qytetit për banorët. Ndër rastet e shumta që ndeshet ne kemi sjellë shembujt: *Për mendjemadhësinë e pafre të këtij qyteti kishte shpjegime të ndryshme* (f. 15); *Shpërfillja me të cilën qyteti dukej se ndiqte ngjarjen më të rëndësishme të kohës, ngjante e natyrshme* (f. 87); *Qyteti pritej të egërsohej* (f. 111); *Qyteti ishte kapur në një ngërç të paparë* (f. 112); *Qytetin e priste një befasim i rrallë* (f. 118) etj. “Darka e gabuar” është pjesë e atyre veprave që e shpirtëzojnë dhe e monumentalizojnë artistikisht qytetin e lindjes së autorit, Gjirokastrën.

Opusi figurativ i kadarean është mjaft i pasur me metafora, metonimi, epitete e krahasime të larmishme që i japin vlerë veprës, megjithatë *metafora është një nga gurët e themelisë së gjuhës dhe stilit të Kadaresë*.<sup>11</sup> Si në gjithë krijimtarinë e shkrimtarit që karakterizohet nga ligjërimi metaforik edhe romani “Darka e gabuar” të mrekullon me metafora befasuese. Disa prej tyre janë: *Fije të tjera hamendjesh nisën të valviteshin* (f. 42); *vrulli i fantazisë fajkërkuese* (f. 124); *Zembreku i shihurur i mendimit punonte jashtë vullnetit të tij* (f. 172); *hiri i ftohtë i harresës* (f. 135) etj. Veç metaforave emërore dhe foljore absolute, komplekse, konceptuale, stilistikore vend të rëndësishëm zënë epitetet metaforike, si: *Vështrimin e kishte të akullt* (f. 46); *pakt epokash të vdekura* (f. 171); *ne i besojmë diellit tënd idealist* (f. 173); që i bënte të binin zonjat e parrëzueshme (f. 114); ky ishte një *trazim tinzar...* i ngjashëm me *tundimin mëkatnor...* të kishin një

<sup>11</sup> T. Çausi, *Universi letrar i Kadaresë*, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1993, f. 266.

*përfytyrim të shtrajtuar* jo vetëm për grekët. ...*katund kryeneç e idhnak* si ky nuk mbahej mend (f. 16) etj. Strukturat metaforike të krijuara prej Kadaresë nga njëra anë dëshmojnë mjeshtërinë e tij në afrimin e fjalëve e nga ana tjetër shprehin vlerën e re kuptimore që marrin njësitë e përfshira në konstruktet figurative.

Si përfundim mund të themi se origjinaliteti krijues e ka bërë Ismail Kadarenë një nga personalitet më të shquara të letërsisë e gjuhës shqipe. Ai di të zgjedhë dhe të trajtojë fabula interesante me një ligjërim mjeshtëror. Gjuha dhe stili janë bartëse fanatike të universit të tij psikologjik. *Nderimi që ka Kadareja për gjuhën shqipe, ndjeshmëria dhe pasioni ndaj saj, krijon shpërthime, rrezatime, vezullime të tilla të fjalës që më së miri përlligjin bërthamat e tyre kuptimore dhe janë mbresëlënëse për çdo lexues.*<sup>12</sup> Mjeshtëri këto, që vihen re dhe në arkitekturën ligjërimore të romanit enigmatik “Darka e gabuar”, cili përcjell tiparet kryesore të gjuhës dhe stilit që e bëjnë të veçantë dhe të admirueshëm shkrimtarin.

#### BIBLIOGRAFI

- E. Sadiku, *Variacione sinonimike në letërsinë artistike*, “Gjuha jonë”, 3, 1989.  
 E. Sadiku, *Zgjerimi semantik në letërsinë artistike*, “Gjuha jonë”, 3, 1988.  
 F. Bejo, *Shprehësia konative e fjalëve në prozën tonë artistike*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1991.  
 Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008.  
 I. Goçi, *Antonimet stilistike në gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1987.  
 I. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985.  
 J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (Botimi i tretë), Tiranë, 2005.  
 J. Thomai, *Ligjërimi lasgushian: semantikë leksikore e semantikë poetike*, “Studime filologjike”, 2000, nr. 1-2.  
 K. Bihiku, *Roli i shkrimtarëve për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës letrare*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1985.  
 T. Çausi, *Universi letrar i Kadaresë*, Tiranë, 1993.  
 V. Isufaj, *Komente në pasthënien e romanit “Mjegullat e Tiranës” të Ismail Kadaresë*, Tiranë, 2014.  
 Xh. Lloshi, *Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1970.  
 Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika* (ribotim), Tiranë, 2005.

<sup>12</sup> Vjola Isufaj, *Komente në pasthënien e romanit “Mjegullat e Tiranës” të Ismail Kadaresë*, Tiranë, 2014, f. 298.